

STATUT DHE AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"IMPERIAL OIL"

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
- "Statuti", eshte statuti i Shoqerise;

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

Neni 1

Data themelimit, Emri, Themeluesit

1. Sot me daten me daten 20.05.2019, une themeluesi **Albet Xhevair SUFA**, lindur, me 17.07.1988, ne Ceren Diber, me leternjoftim nr. **I80717106P**, madhor me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar, **me adrese "Paskuqan, Tirane"**, aktualisht banues ne Kanada, kam themeluar Shoqerine me emrin **"IMPERIAL OIL"**.
2. Shoqeria eshte themeluar ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqeria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.
4. Shoqeria **"IMPERIAL OIL" sh.p.k**, eshte Person Juridik Shqiptar dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Statutin dhe Aktin Themelimit, qe behen pjese e pandare e tij.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i Shoqerise eshte si me poshte vijon:

"Tregti me pakice e te gjitha llojeve te karburanteve, gazit e nenprodukteve te tyre, vajrave lubrifikante, bar-kafe, fast food, tregti me pakice e artikujve ushqimore dhe industriale, servis automjetesh, gomisteri, lavazh, qiradhenie, transport mallrash per nevojat e tij etj.

Albet Sufr


Neni 3 **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Selia e Shoqerise

1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: " **Fushe-Preze, Vore, Tirane, numer pasurie: 150/10/ND, Zona Kadastrale Nr. 3049**".
2. Adresa e faqes se internetit te Shoqerise eshte:
3. Adresa e Shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte: **imperialshpk@gmail.com**
4. Aktiviteti i shoqerise shtrihet brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Shoqeria mund te themeloje dege, filiale dhe zyra perfaqesimi ne Shqiperi, e jashte saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte **60.000.000 (gjashtedhete milione)** leke. Kapitali themeltar eshte ne natyre, pasuri e patundshme, eshte shlyer teresisht me blerjen e prones ku do te zhvillohet aktiviteti i shoqerise. Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin si me poshte:
2. Ortaku themelues **Albet Sufa, zoterues i 1 (nje) kuote**, me vlere te pergjitheshme prej **60.000.000 (gjashtedhete milione leke, ne natyre, pasuri e patundshme)**, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.


Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe per kontributet ne natyre, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar nga Gjykata kopetente, per keto kontribute sipas kerkeses se bere nga ana administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Albet Sufa


Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre, mund te fitohen dhe kalohen vetem nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise,
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, perderisa nuk parashikohet ndryshe ne kete statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve, eshte organi me i larte vendim-marres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve ka keto Kompetenca:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
 - b) Ndryshimet e Statutit,
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit
 - d) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
 - e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne c) dhe d)
 - f) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
1. Asambleja merr vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat "g" dhe "h" te pikes 2 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.
 2. Vendimet e marra nga Asambleja rregjistrohen ne nje rregjister te vendimeve, te cilat nuk mund te ndryshohen ose fshihen, por ne vecanti duhet te rregjistrohen vendimet e mepostme:

Albert Sula
[Signature]

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Shperndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve.
- Investimet.
- Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendim-marres i shoqerise. Ajo mblidhet ne seanca te zakonshme te pakten nje here ne vit apo sa here kerkohet ne perputhje me Ligjin 9901/2008 "Per Tregetaret e Shoqerite Tregetare".
2. Administratori ka per detyre te njoftoje Ortaket per mbajtjen e mbledhjes se Asamblese me shkrim nepermjet postes se regjistruar te pakten 7 dite perpara organizimit ose nepermjet postes elektronike, ku duhet te perfshije:
 - a) rendin e dites per te cilin do diskutohet
 - b) kohen (daten oren)
 - c) vendin e mbajtjes se mbledhjes
3. Per efekt vlefshmerie dergimi i njoftimeve per mbledhjen e Asamblese dhe marrja e tyre ne dorezim nga ortaket duhet te pasqyrohen ne librat e protokollit te shoqerise ose/dhe te arkivohen te shoqeruara me mandatet postare perkatese.
4. Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas procedures se mesiperme, ajo mund te marre vendime te vlefshme, nese te gjitha ortaket jane dakord per te marre vendime.

Neni 10

Kuorumi

1. Per marrjen e vendimeve ne mbledhjet e Asamblese qe kerkojne shumice te cilesuar,kerkohet nje kuorum prej 50% te numrit te pergjithshem te ortakeve present.
2. Per ceshtje te tjera te parashikuara ne ligj Asambleja e ortakeve vendos me shumicen e thjeshte te votave , kur kuorumi minimal i pjesmarrjes eshte 30% .
3. Kur Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses kuorumi te percaktuar me lart, asambleja mblidhet perseri brenda 30 diteve me te njejtin rend dite.


Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e Pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,

Albet Suk


- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore te shoqerise dhe raporteve te ecurise veprimtarise,
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,

Cdo ndryshim statuti duhet te dorezohet prane QKB, per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 **Perjashtimi nga e drejta votes**

- 1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes, nese Asambleja e Pergjithshme vendos per:
 - a) Vleresimin e veprimtarise se tij,
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
 - c) Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria,
 - d) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja,
- 2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 **Administrimi**

- 1) Asambleja e Pergjithshme emerom nje ose disa persona fizike si administratore, te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripertitje. Emerimi administratoreve prodhon efekte, pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundertshtim me keto dispozita, eshte i pavlefshem.
- 3) Personi i meposhtem emerohet si administrator i shoqerise, deri ne emerimin e saj nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme:


Te dhenat e identifikimit:

Sufa Marjana, Atesia: Xhevair, lindur, me:02.05.1993, ne Ceren, Diber, mbajtese e ID Nr. J35502085F, Adresa: Rr" Siri Kodra", Njesia 9, Tirane.

Neni 14 **Kompetencat e administratorit**

Administratori kane te drejte dhe detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme. Ne raste te veçanta Administratori mund te autorizojë me prokure te posaçme

Albet Sufe


konform dispozitave perkatese te Kodit Civi, nje person te trete, te perfaqesoje shoqerine,

- b) Perfaqesoje shoqerine tregtare,
 - c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave e librave kontabel te shoqerise,
 - d) Pergatit e nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimit, ia paraqet Asmblese se Pergjithshme per miratim,
 - e) Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur, per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen dhe ekzistencen e shoqerise,
 - f) Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit,
 - g) Raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare te shoqerise dhe per realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante, per veprimtarine tregtare te shoqerise,
 - h) Kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut,
- Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise, nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim,
 - Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, qe kane vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,
 - Shoqeria, brenda dy viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje me shumice te zakonshme administratorin ne cdo kohe.

Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.


Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise apo te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja, qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale, ose solidarisht sipas rastit pasojat.

Pervec, sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per tregtaret e shoqerite tregtare", administratori detyrohet:

1.a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut, ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante, ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis,

A. B. Suter


- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj e ne statut vetem per arritjen e qellimeve qe pershkruhen ne keto dispozita,
- c) te vleresojte me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim,
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise,
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e duhur,

2. Administratori, gjate kryerjes se detyres se tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori, vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal, qe ai apo personat e lidhur me te, kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij sipas rregullave dhe standarteve te kerkuara. Kur shkelja, eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen perpara shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

- a) U kthen ortakeve kontributet,
- b) U paguan ortakeve interesa apo dividente,
- c) U shperndan aktivet e shoqerise,
- d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet,
- e) Jep kredi,


Pervec padise per shlyerjen e demit, qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrejne padi penale ndaj administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e padise kunder administratorit, per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16 Viti Financiar

1. Viti financiar fillon ne 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor te cdo viti kalendarik. Ne perfundim te vitit kalendarik administratori harton pasqyrat financiare te Shoqerise ne perputhje me ligjet ne fuqi.
2. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

Albert Suka


3. Aktivitetit financiar i shoqerise mund te kontrollohet nga eksperte kontabel te autorizuar te emeruar nga Asambleja e Ortakeve.
4. Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori kryen te gjitha veprimet e nevojshme per pergatitjen e bilancit vjetor dhe te dokumenteve kontabile ne perputhje me afatet ligjore.

Asambleja e ortakeve vendos ne lidhje me shperndarjen e fitimit neto (dividend) qe rezulton nga bilanci i miratuar.

Neni 17 Ekpertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate gjithvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille, i ngarkuar nga ana ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar, pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate te kontroleve periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar t'ia u paraqese ne kohe ortakeve te shoqerise, per t'i shqyrtuar e miratuar ne baze te se drejtes vendimore qe kane.

KREU V PRISHJA-RIORGANIZMI I SHOQERISE

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit,
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43, te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",
- e) Me vendim te gjykates,

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim, ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "**Shoqeri ne likuidim e siper**".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje proces falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues.

Albet Suti


Neni 19
Riorganizimi i shoqerise, bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet apo bashkohet, sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen e IX, te ligjit nr.9901, date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 20
Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj tregtar ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cdo ligj specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21
Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe cdo mosmarveshje qe mund te lind ndermjet Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjyaka Shqiptare.

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"IMPERIAL OIL"

Albet SUFA

